

## TERMAT E REFERENCES

<b>Lloji i shërbimit</b>	Zhvillimi dhe realizimi i një video animacion për vetëdijesimin dhe sensibilizimin e popullatës për rëndësinë e shërbimeve sociale si dhe nxitjen e veprimeve të institucioneve për të trajtuar me prioritet miratimin e Projektligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare në mënyrë që të sigurohen shërbime sociale cilësore dhe të qëndrueshme për njerëzit në nevojë sociale.
<b>Vendi</b>	Kosovë
<b>Lloji i pozitës</b>	Kompani
<b>Kohëzgjatja</b>	Tetor-Dhjetor 2023
<b>Data e pritshme e fillimit</b>	Tetor 2023
<b>I raporton</b>	SOS Fshatrave të Fëmijëve Kosovë

### 1. Hyrje

Këto terma të referencës shërbejnë si kërkesë për propozime për kompani që janë të interesuar për zhvillimin dhe realizimin e një video animacion për vetëdijesimin dhe sensibilizimin e popullatës për rëndësinë e shërbimeve sociale si dhe nxitjen e veprimeve të institucioneve për të trajtuar me prioritet miratimin e Projektligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare në mënyrë që të sigurohen shërbime sociale cilësore dhe të qëndrueshme për njerëzit në nevojë sociale.

### SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë

SOS Fshatrat e Fëmijëve Internacional është organizata ombrellë e federatës botërore të 118 shoqatave kombëtare të SOS Fshatrave të Fëmijëve, që veprojnë me programet e tyre në më shumë se 2500 vende në tërë botën. Ne punojmë bashkërisht me një vizion të vetëm: çdo fëmijë i përket një familje dhe rritet me dashuri, respekt dhe i sigurt. Ne ofrojmë përkujdesje afatgjatë familjare, në mënyrë unike, për fëmijët që e kanë humbur kujdesin prindëror (shërbimi i kujdesit alternativ), dhe punojmë me familjet dhe komunitetet e cënueshme për t'u ndihmuar që të fuqizohen dhe ta parandalojnë braktisjen e fëmijëve (shërbimi për fuqizimin e familjes, SHF). SOS kujdesi alternativ zakonisht organizohet në formën e një grupimi të SOS familjeve, ku secili prind i SOS përkujdeset për një grup të vogël të fëmijëve.

Që nga viti 2001, SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë ka vepruar në mënyrë aktive në fushën e mbrojtjes sociale duke ofruar shërbime të drejtpërdrejta dhe të cilësisë së lartë të kujdesit ndaj fëmijëve dhe të rinjve pa përkujdesje prindërore nëpërmjet zhvillimit të një mjedisi alternativ të

kujdesit familjar dhe shërbimeve të bazuara në komunitet për familjet e rrezikuara. Në kuadër të programeve të SOS Fshatrave të Fëmijëve dhe atyre për fuqizimin e familjeve, ne punojmë së bashku drejt vizionit tonë për një botë ku “çdo fëmijë i përket një familje dhe rritet me dashuri, respekt dhe i sigurt”. SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë punon në partneritet me institucionet përgjegjëse, organet shtetërore, akterët kryesorë, organizatat kryesore dhe ofruesit e shërbimeve në fushën e mbrojtjes sociale të fëmijëve në nevojë, dhe u krijon mundësi të rinjve që të përfshihen me kontributin dhe ndikimin e tyre në formësimin dhe hartimin e politikave dhe në zhvillimin e shërbimeve dhe programeve.

### **1.1 Konteksti i programit**

Në kuadër të fushëveprimit të avokimit të organizatës ne punojmë në drejtim të sigurimit të shërbimeve cilësore dhe mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve pa kujdes prindëror dhe në rrezik të humbjes së kujdesit prindëror. Në këtë rast Strategjia e Avokimit dhe zhvillimi i fushatës avokuese hartohet dhe zhvillohet në një moment kyç të reformave ligjore të mbrojtjes dhe fuqizimit të shërbimeve sociale dhe familjare në Kosovë. Në kuadër të Strategjisë Nacionale të Avokimit 2022-2025, SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë po kërkojnë një kompani për zhvillimin dhe realizimin e një video animacion për vetëdijësimin dhe sensibilizimin e popullatës për rëndësinë e shërbimeve sociale si dhe nxitjen e veprimeve të institucioneve për të trajtuar me prioritet miratimin e Projektligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare në mënyrë që të sigurohen shërbime sociale cilësore dhe të qëndrueshme për njerëzit në nevojë sociale.

### **1.2 Pasqyra e përgjithshme e programit**

SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë janë të interesuar **për Kompani – për realizimin e një videoje** për zhvillimin dhe realizimin e një video animacion për vetëdijësimin dhe sensibilizimin e popullatës për rëndësinë e shërbimeve sociale si dhe nxitjen e veprimeve të institucioneve për të trajtuar me prioritet miratimin e Projektligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare në mënyrë që të sigurohen shërbime sociale cilësore dhe të qëndrueshme për njerëzit në nevojë sociale.

#### **Zhvillimi dhe realizimi i video animacionit:**

- Realizimi i (1) një videoje animacion sensibilizues 60 – 90 sekonda - nga versioni i videos së gjatë të prodhohet një video e shkurtër 30 sekondash për përdorim në rrjete sociale (Facebook, Instagram, Twitter, LinkedIn, Website), titrat në gjuhën angleze dhe serbe në të dy versionet e videos;

- Video duhet të jetë e realizuar në mënyrë profesionale dhe me kualitetit të lartë – preferohet formati HD 1080P
- Të paraqitet plani dinamik i realizimit të videos (periudhën e fillimit dhe të dorëzimit të produktit)
- Videoja është paraparë të zhvillohet gjatë muajve: Shtator - Dhjetor 2023.

### Grupi i synuar:

- **Grupi i parë:** *Politikë bërësit dhe vendimmarrësit*- do të jenë grup i synuar në nxitjen për miratim të Projektligjit për Shërbime Sociale dhe politikave në fushën e mbrojtjes së fëmijëve si dhe sensibilizimi dhe mobilizimi i autoriteteve shtetërore relevante në nivel lokal dhe nacional dhe i akterëve të tjerë në çështjet e mbrojtjes së fëmijëve.
- **Grupi i dytë:** *Familjet, Fëmijët dhe të rinjtë*- do të jenë grup i synuar për të ndikuar në rritjen e vetëdijes së tyre për përfitimet që sjell ky Ligj.
- **Grupi i tretë:** *Popullata e gjerë në Kosovë*- do të jetë grup i synuar për të rritur vetëdijesimin tek opinioni i gjerë për çështjet e mbrojtjes dhe shërbimeve sociale.

### Kapacitetet e kompanisë:

Aftësitë minimale që kërkohen nga Kompania aplikante:

- Kompania ka kapacitete të mjaftueshme dhe të kualifikuara njerëzore dhe teknike për të kryer punën me profesionalizëm dhe brenda afatit kohor të caktuar nga Fondacioni SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë;
- Përvojë e dëshmuar në fushën e realizimit të fushatave/videove vetëdijësuese;
- Vlerësimi i 3 videove shembuj të punës së ngjashme.

### Përgjegjësitë:

Prodhimi i kësaj video animacion do të implementohet nën mbikëqyrjen dhe udhëzimin e drejtpërdrejtë të ekipit të SOS Fshatrave të Fëmijëve Kosovë, kompania do të ofrojë si vijon:

- Zhvillojë konceptin dhe skenarin e përgjithshëm të videos në kohëzgjatje deri në 60-90 sekonda dhe versionit të shkurtër 30 sekondash;
- Zhvillojë skenarin e videos;
- Paraqesë një draft të videos tek ekipi për komente dhe sugjerime dhe t'i rishikojë ato;
- Mbajë kontakte të rregullta me ekipin e SOS Fshatrave të Fëmijëve Kosovë gjatë gjithë fazës së para-produksionit, produksionit dhe post-produksionit të videos
- Sigurojë respektimin e udhëzimeve të vizibilitetit nga SOS Fshatrat e Fëmijëve.

### **Detyrat:**

- Të paraqes konceptin dhe skenarin/skriptën e përgjithshme;
- Të paraqes draft videon tek ekipi i SOS Fshatrave të Fëmijëve Kosovë dhe të adresojë komentet e nevojshme/potenciale;
- Të prodhojë dhe ofrojë produktin final: një video animacion sensibilizues deri në 60-90 sekonda dhe versini i shkurtër 30 sekondash;
- Të dorëzojë kopje digjitale të produktit final;
- Të ofrojë shërbime pa vonesë dhe në kohën e duhur, sipas kushteve të parapara në kontratën e nënshkruar në mes të ofertuesit dhe projektit.

### **Afatet kohore:**

- Dorëzimi i një skeme maksimum prej 1-2 faqesh të planit/skenarit për prodhimin e videos një javë (10 ditë kalendarike) nga nënshkrimi i kontratës së shërbimit;
- Dorëzimi i skenarit dhe strukturës së videos jo më vonë se 2 javë nga nënshkrimi i kontratës;
- Paraqitja e draftit të parë të videos brenda (8) nga data e nënshkrimit të kontratës;
- Adresimi i komenteve dhe sugjerimeve te nevojshme/ potenciale të dhëna nga ekipi i projektit në përputhje me afatet e përcaktuara nga ekipi i projektit;
- Finalizimi i videos deri në javën e fundit të tetorit 2023;
- Të gjitha informatat që kanë të bëjnë me këtë projekt, të tilla si drafte/versione të videos, mbeten pronë e SOS Fshatrave të Fëmijëve Kosovë, i cili do të ruajë të drejtat ekskluzive mbi të drejtat e autorit dhe përdorimin në të ardhmen.

### **Dokumentet që duhet dorëzuar:**

- Certifikatën e regjistrimit te biznesit/ NUI
- Oferta financiare e nënshkruar dhe vulosur ose me llogo zyrtare
- Çmimi duhet të jetë në Euro pa TVSH
- CV e Kompanisë (video, portfolio apo dokument që tregon disa shembuj të punës).
- 3 video shembuj të punës së ngjashme
- Kontakti: e-mail, numri i telefonit të Kompanisë

**Oferta duhet të jetë e vlefshme për 30 ditë nga data e mbylljes së Ftesës për Ofertë**

Kriteret e përzgjedhjes janë:

Kriteret	Maksimumi i pikëve
<ul style="list-style-type: none"> <li>Kompania ka kapacitete të mjaftueshme dhe të kualifikuara njerëzore dhe teknike për të kryer punën me profesionalizëm dhe brenda afatit kohor të caktuar nga Fondacioni SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë që përfshinë:</li> <li>CV e Kompanisë/ Portfolio</li> <li>Dokument që tregon disa shembuj të punës</li> <li>Kapacitetet teknike dhe njerëzore</li> </ul>	10 10 10
<ul style="list-style-type: none"> <li>Vlerësimi i 3 videove shembuj të punës së ngjashme</li> </ul>	40
<ul style="list-style-type: none"> <li>Çmimi i ofertës financiare</li> </ul>	30
<b>Totali</b>	<b>100</b>

Me rastin e nënshkrimit të kontratës, në rast të performancës jo të kënaqshme, SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë do të negociojnë me kompaninë e përzgjedhur në mënyrë që të mund të ndryshohet puna/ materialet. Nëse puna e bërë nuk arrin t'i përmbushë pritjet, kontrata do të ndërpritet nëpërmjet një njoftimi paraprak me shkrim prej shtatë (7) ditësh. Në ndërkohë, SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë do të fillojë me një proces të ri të përzgjedhjes.

## 5. Kohëzgjatja e kontratës dhe kushtet e pagesës

Pagesa do të bëhet nga SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë, me pranimin e punës së kryer në përputhje me specifikacionet e përshkruara më lartë. Pagesa do të kryhet me transfer bankar brenda afatit prej 15 ditësh pas ofrimit dhe aprovimit të shërbimit.

## 6. Të drejtat e autorit dhe të drejtat tjera pronësore

SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë do ta ketë të drejtën mbi pronësinë intelektuale dhe të drejtat tjera të pronësisë, pa asnjë kufizim në të drejtat e autorit, për sa i përket të gjitha specifikacioneve të cekura më lart të cilat i ka zhvilluar Kontraktuesi për SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë në kuadër të kontratës.

Të gjitha materialet dhe të gjitha të dhënat e tjera që janë përgatitur nga Kontraktuesi ose janë pranuar nga Kontraktuesi do të jenë në pronësi të SOS Fshatrave të Fëmijëve Kosovë dhe do të trajtohen si konfidenciale dhe do t'i dorëzohen vetëm SOS Fshatrave të Fëmijëve Kosovë me përfundimin e punës sipas kontratës.

**Aplikimi:**

Oferta duhet të dërgohet në e-mail adresën: [procurement1@soskosova.org](mailto:procurement1@soskosova.org) deri me datën: **28.09.2023** në mesnatë.